

P.nr. 146/2006

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN- Departamenti për Krime të Rënda, si penale, në trup gjykues të përbërë prej gjykatësit Xheladin Osmani-kryetar i trupit gjykues dhe gjyqtarve Xhemil Elshani dhe Vjollca Buzhala, si anëtar të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatmire Kastrati, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit J. K. nga Prizreni, për shkak të veprës penale të grabitjes nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të KPK, duke vendosur sipas aktakuzës së PPQ në Prizren, P.nr.110/2001, e datës 19.12.2001, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor më datë 11.01.2016, 25.03.2016, 08.04.2016, 21.04.2016, në prezencën e përfaqësuesit të akuzës, Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, Metush Biraj, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij avokatit R. K., me datën 27.04.2016, muar dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M**I Akuzuari :**

J. K., nga i ati H. dhe e ëma N., me mbiemër të vajzërisë M., data e lindjes... në Prizren ku edhe jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 390 par.3 të KPPK.

LIROHET NGA AKTAKUZA

1. Sepse të akuzuarit B. B., A. D., L. T., K. K. dhe J. K., 17.08.2000, duke filluar prej orës 02,00 gjërë në ora 04,45 minuta, të armatosur, hyjnë në shtëpinë e të dëmtuarit R. B., pasi që i lidhin anëtarët e familjes së të dëmtuarit, me përdorimin e forcës dhe me kanosje, nga shtëpia e të dëmtuarit marrin: 4 hallka, një zingjir të dorës, 4 unaza, 2 palë vathë, 2 lira e gjysmë, një zingjir të arit , 3 lira, një zingjirë të arit me vlerë 1.600 DM, 14 qereka të lirës, një komplet të arit të vajzës së të dëmtuarit, i marrin 17.000 DM, një revole, dy telefona mobil si dhe orën e dorës së të dëmtuarit R., e pastaj me të filluar të zdrejtë largohen nga vendi i ngjarjes.

Këso dore kishte për të kryer veprën penale të grabitjes nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të KPK .

I dëmtuari R. B., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Për të akuzuarin në kuptim të nenit 103 par.1 të KPPK-së, shpenzimet procedurale, bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria e Qarkut në Prizren, me aktakuzën PP.nr.110/2001 të dt.19.12.2001, ka akuzuar B. B., A. D., L. T., K. K. dhe J. K., që të gjithë nga Prizreni, për shkak si bashkëkryerës të disa veprave penale të grabitjes nga neni 137 të LPK-së i aplikuar sipas Dekretit të UNMIK-t.

Më aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren P.nr.234/2001, dhe P.nr.73/2002 është kundërshtuar si e pabazë kërkesa e prokurorit që ai akuzuari J. K. të gjykohet në mungesë, kështu që ndaj të akuzuarve respektivisht të akuzuarit J. K. janë të NDARA (është ndarë procedura penale ndaj të akuzuarit J. K., me të akuzuarit tjerë) nga procesi penale me arsyetim se i akuzuari gjendet në arrati.

Më aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, P.nr.234/01 të dt.08.02.2005 i akuzuari J. K., për veprën penale të grabitjes nga neni 137 të LPK i aplikuar, është shpallur fajtor dhe është dënuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 2 (viteve), dhe me ankesë së të mbrojtësit, Gjykata Supreme e Kosovës, me aktvendimin Ap.nr.203/2005, ka aprovuar ankesën e mbrojtësit, dhe këtë aktgjykim të Gjykatës së Qarkut e ka prishur dhe lëndën ia kthen gjykatës së shkallës së parë për rigjykim. Gjykata e Qarkut në Prizren, me aktgjykimin e saj P.nr.155/2005, të dt.17.12.2005, të akuzuarin serish e shpall fajtor dhe ia shqipton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, mirëpo më ankesë përsëri të mbrojtësit Gjykata Supreme e Kosovës, Ap.nr.128/2006, të dt.06.04.2006, sipas detyrës zyrtare aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, e prish dhe çështja kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim, tani para trupit tjetër gjykues.

Gjykata Themelor në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, ka filluar me rigjykimin e kësaj çështje penale dhe ka vepruar sipas rekomandimeve të Gjykatës Supreme ku ndër të tjera është theksuar se i akuzuari B. B. (si bashkëkryes), është dashur të dëgjohet në cilësi të dëshmitarit, pavarësisht nga informata e SHPK-së, më të cilin informohet gjykata se nuk mundë të sigurohet prezenca e tij në gjykatë nga institucioni ku vuan dënimin , sepse qenka i burgosur i kategorisë A, e arsyetimi i këtillë me aktgjykimin e goditur është në kundërshtim me dispozitat e përmendura ligjore.

Më datën 11.01.2016, në shqyrtimin kryesor, ka ftuar dhe ka dëgjuar të akuzuarin J. K., të dëmtuarin R. B. dhe dëshmitarin B. B., pastaj në shqyrtimin kryesor të dt.25.03.2016, serish dëshmitarin B. B., dëshmitarin B. M., kurse më dt.08.04.2016 me propozim të prokurorit është ftuar dhe dëgjuar serish i dëmtuari R. B. Është lexuar deklarata e të dëmtuarit R. B. të dhënë në procedurën hetimore, është lexuar raporti i policisë 2000 JA 1131 të dt.13. dhe 14.03.2003, është bërë shikimi i fotodokumentacionit nga shkresat e lëndës, është lexuar vërtetimi mbi marrjen e sendeve të dërguara në Prokurorinë e Qarkut në Prizren, PP.nr.110/2001 të dt.07.02.2002, më të cilin akt është dërguar edhe vërtetimi mbi marrjen e sendeve 2000-JA-1131, janë lexuar shkresat e policisë që kanë të bëjnë më të dëmtuarin R. B..

Aktakuzën gjatë shqyrtimit kryesor e ka përfaqësuar prokurori i shtetit Metush Biraj, i cili në fjalën e tij të fundit të shqyrtimit kryesor të dt.21.04.2016, ka theksuar se nga provat e administruara, më pa mëdyshje është vërtetua teza e kësaj aktakuze se i akuzuari J. K. ka kryer veprën penale grabitje në bashkëkryerje nga neni 255 par.1 lidhur me par.3 të KPK, për çka gjykatës i propozoj që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të gjykohet sipas Ligjit. Nga deklarata e të dëmtuarit R. B. i dëgjuar edhe si dëshmitar, më pa mëdyshje vërtetohet fakti se i njëjti pikërisht nga dëshmitari B. B. është njoftuar se përveç të tjerëve edhe i akuzuari J. K. ka marrë pjesë në grabitjen në shtëpinë e tij më dt.17.08.2000, të cilin fakt e thotë edhe vet dëshmitari B. B. Në vazhden e kësaj dëshmitari B. pretendon se nga personi X nga i cili e ka blerë orën e grabitur në shtëpinë e të dëmtuarit R. B., është njoftuar për kryerësit e kësaj vepre penale, ndërsa për veti insiston se nuk ka qenë pjesëmarrës në kryerjen e kësaj vepre penale , thotë se sot është fakt botërisht i njohur e që në dijeni edhe vet trupi gjykuese me aktgjykimin e plotfuqishëm dëshmitari B. B. është në fund të vuajtjes së dënimit, prandaj trupit gjykues i propozoj që këtë pjesë më të merret parasysh deklarata e dëshmitarit, e kjo shifet qartë se i njëjti me këtë deklaratë përveç që tenton ta shmang veten nga kryerja e veprës penale për të cilën e ka vuajtur dënimin ,

mundohet që në këtë mënyrë të i ndihmoj të akuzuarit J. K. në shmangien e përgjegjësisë për këtë veprë penale. Trupit gjykues i propozoj gjithashtu mos të miret parasysh as mbrojtja e të akuzuarit J. K. kur thotë se në kohën kur qenka kryer kjo veprë penale e që në fakte edhe është kryer, ai sipas sygjërimeve të mbrojtjes së tij diku në muajin Qershor 2000 paska ikur në Shqipëri sepse mbrojtësi këtij nuk paska mundur ti garantoj sigurinë se mos të ndiqet për këtë veprë penale. Andaj gjykatës i propozoj që këto pretendime të të akuzuarit dhe një pjesë të deklaratës së dëshmitarit B. B. të mos merren parasysh sepse është tejdukshme që dëshmitari B. nuk është objektiv dhe real nga se si që dihet i njëjti ka qenë inspirator, organizator dhe pjesëmarrës bashkë me të akuzuarit tjerë në grabitjen e shtëpisë së të dëmtuarit R. B., e aq më tepër kur vet dëshmitari B., për orën që është vjedhur në shtëpinë e të dëmtuarit, here thotë se e ka patur dhuratë nga i afërmi i tij prej Zvicre, e pastaj pretendon se këtë orë e paska blerë nga personi X e që në fakt ky pretendim është produkt i imagjinatës së tij, me qëllim që trupin gjykues ta ven para dilemave për këtë rast penal.

Në funde gjykatës i propozoj që prej rrethanave rënduese ndaj të akuzuarit të këtë parasysh peshën e veprës penale dhe pasojat e saja, shkallen e përgjegjësisë së tij e sidomos rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, kurse prej rrethanave lehtësuese të këtë parasysh qëndrimin korrekt dhe mjaft kooperues të akuzuarit dhe para trupit gjykues, faktin se i njëjti tash është njeri familjar, se nuk kemi ndonjë fakt se ai ndërkohe është kryerës i ndonjë veprë të re penale dhe periudhën kohore nga koha kur është kryer vepra penale.

I akuzuari J. K. deklaron se qëndron në tërësi pranë dy deklaratave të tija të dhënë në shqyrtimin kryesor të dt.02.02.2005 dhe dt.17.11.2005. B. B. e kam njohur për herë të parë në Burgun e Dubravës në vitin 2005 ku në atë kohë kam qenë në vuajtjen e dënimit gjerë në plotfuqishmërinë e aktgjykimit dhe të njëjtin njëherit e kam takuar para dy muj e gjysmë këtu në gjykatë. Në vitin 2000 dhe 2001 fare nuk jam shoqëruar me B. B., Në vitin 2001 unë nuk kam qenë fare në Kosovë, por kam qenë në Shqipëri, kurse në vitin 2000 kam qenë në Prizren ku jam marrë me veprimtarinë e prodhimit të kockave të betonit. Është e vërtetë se është bastisur shtëpia ime nga ana e pjesëtarëve të policisë, por me qenë se unë nuk kam qenë prezent në shtëpi gjatë bastisjes, nuk e di se a kanë qenë policë vendor apo ndërkombëtar. Në shtëpi janë gjetur një sasi e të hollave rrethe 30.000 Marka Gjermane ato të holla kanë mbetur nga shitja e banesës të cilën e kemi patur në Ortakoll, ku kam lidhur kontratën me blerësin, nuk jam i sigurt se a gjendet kontrata në shtëpi, por nëse e gjej do të ia jap avokatit tim për të proceduar me të. Bastisja në shtëpinë time është bërë në muajin qershor të vitit 2000 dhe përveç të hollave që i përmendëm nuk është gjetur asgjë tjetër. Shitjen e banesës e kemi bërë në vitin 2000. Personat me emrat A.D. dhe L. T. atëherë nuk i kam njohur, të njëjtët i kam njohur pasi kam dalë prej burgut. Gjithashtu nuk i njoh personat me emrat L. L., N. G., H. G., B. B., S. K. e Z. M edhe sot nuk i njoh. Gjithashtu nuk i njoh personat me emra Xh. B., E. M. dhe Sh. Q.. Nuk e njoh gjithashtu edhe të dëmtuarin R. B. të njëjtin e kam pa sa më duket në shqyrtimin kryesor. Nuk e njoh as personin me emrin B. M., e as që kam dëgjuar ndonjë herë për to.

Në pyetjen e mbrojtësit të tij a të kujtohet se çfarë stine ka qenë kur është bërë bastisja, i akuzuari deklaroj se ka qenë pranverë, muaji maj – qershor i vitit 2000. Sa më kujtohet prej dt.01.06.2000 kam shkuar në Shqipëri, sepse kam dëgjuar se është bastisur shtëpia ime me sygjërimet të mbrojtësit tim, av. nga Prishtina, kur më ka thënë “Largohu prej Kosovës sepse është rrëmujë e madhe, nga se janë tuj ndodhë arrestimet, dhe nuk mund të jap sigurim apo mbrojtje”. Nuk e ndij veten fajtor sepse në asnjë veprim nuk kam kryer veprën penale për të cilën akuzohem nga Prokuroria atëherë e Qarkut në Prizren.

I dëmtuari R. B., deklaroj se kam dhënë deklaratën në Prokurorin e Qarkut në Prizren si dhe para gjyqtarit hetues, në Gjykatën e Qarkut në Prizren dhe qëndroj në tersi pranë atyre

deklaratave. Ka qenë viti 2000, atëherë kamë banuar në rrugën..., ku edhe tani banoj në atë shtëpi kur është bërë sulmi dhe grabitja në shtëpinë time, kjo ka ndodhur diku në fund të muajit Qershor, por data e saktë nuk më kujtohet. Në atë kohë kamë qenë në shtëpi dhe rasti ka ndodh pas ore 01,00 pas mesnate. Gjithë familja kemi qenë në gjumë, kurse një dritare me dimensione 60x80 ka mbet e hapur, kështu që sulmuesit kanë hyrë për dritare, njeri ka hyr për dritare brenda në korridor dhe ka hapur nga brenda derën hyrëse të shtëpisë, pastaj edhe kanë hyr brenda edhe sulmuesit tjerë. Kamë fjetur në katin e parë të shtëpisë, kanë hapur dyert në dhomën ku kamë qenë fjetur dhe në dhomën ku kanë fjetur fëmijët. Sa i përket sulmuesve, kanë qenë 6-7 veta të gjithë kanë patur maska në kokë, i kamë parë se të gjithë kanë qenë të armatosur, kanë qenë me pushkë automatike, kallashë dhe me pistoleta, në dhomën time ku kamë qenë fjetur kanë hyrë 3-4 sulmues, me maska dhe me armë, bashkëshortes i kanë thënë të shkon tek fëmijët kurse mu me kanë lidhë me izolira dhe me spagë dhe nga unë kanë kërkuar të holla dhe e kanë demoluat të gjithë shtëpinë për të gjetur para apo sende me vlerë. Gjatë demolimit të shtëpisë dhe kontrollit ata kanë gjetur 17.000 DM të cilat i kamë fituar para luftës nga puna ndërtimore, gjithashtu sulmuesit kanë marrë edhe arin bashkëshortes, ka qenë sasi e madhe e arit por nuk mundë të përcaktoj në mënyrë individuale se sa ka qenë sasia e arit, por e di se ka pas zingjira, hallka të dorës, unaza të gjitha të arit vlera e të cilave ka qenë diku 10.000 DM. Dikush ka kuptuar që unë do të udhëtoj për në Stamboll , pikërisht ditën e nesërme të natës kritike dhe atë natë kanë hyrë sulmuesit dhe i kanë marrë ato sende të cilat i përmenda. Pra sulmuesit kanë ardhur sipas sugjerimit apo përmes personit që më ka njohur. Natën kritike nuk kamë mujt me identifikuar personat që thash të gjithë ka qenë të maskuar, kanë ushtruar dhunë ndaj meje, i kamë thënë që ti marrin ato të holla që i kam vetëm mos ta maltretonjë familjen.

Rastin e kam lajmëruar menjëherë në polici, të cilët kanë ardhur në shtëpi, e di që kanë qenë pjesëtar të UNMIK-ut, me asnjë vendor, por me përkthyes, kanë bërë fotografimin e shtëpisë dhe gjithashtu me kanë ftuar që të jap deklaratë në polici, ku atje kamë deklaruar siç deklarova edhe sot. Më ka lajmëruar polica se sulmuesit nuk kanë mujt me i gjetë dhe për këtë arsye kurrfarë ballafaqimi me sulmuesit nuk është bërë atëherë.

B. B. pas rastit e kamë takuar kur ai me telefon me ka thirr që të takohemi dhe të me tregoj se kush ka qenë pjesëmarrës në grabitje, me tregoj personat, kanë qenë A. D., K. K., J. K. dhe një person me emrin L. T., ashtu si që kam deklaruar edhe para gjyqtarit hetues dhe mendoj se preteksti i kësaj që më ka tregua B. ka qenë që ti largon nga konkurrenca personat të cilët i përmenda për shkak të shumës së të hollave. Gjatë atij takimi , të akuzuarit B. B. ia kamë par orën time në dorë të cilit i kamë tregu që ora është e imja dhe ia nxora prej dorës-krahut, nuk me kundërshtoj B. dhe ma dha orën. E pyeta B. se ku e ka marrë këtë orë, më tha se “ma ka pru një tezak prej Zvicrës”, ka qenë orë e mirë dhe e shtrenjte. Përveç me B. siç ceka më herët, me këta persona tjerë nuk kamë komunikuar fare. Pas ngjarjes, pas 2-3 muajve, nëpërmjet kushëririt B. M., unë kam identifikuar A. D., K. K. dhe J. K.

Unë si i dëmtuar pa fakte dhe prova nuk mund të deklaroj se mund të dyshoj tek i akuzuari J. K. ngase as nuk e kam pa, sot për herë të parë po e shoh në gjykim. Sa i përket ndjekjes penale këtë ia le në vlerësim të gjykatës, mirëpo po përsëris edhe një herë edhe pse nuk dyshoj tek i akuzuari sepse nuk kam fakte dhe argumente dhe prova, por si që do të jetë unë parashtrij kërkesën pasurore juridike, për shumen do të deklarohej në kontestin civil.

Në pyetjen e prokurorit se përveç sasisë së arit dhe parat që tu kanë vjedhur në shtëpinë tuaj, a të kujtohet se çka të është vjedhur, i dëmtuari deklaroj se janë marrë dy telefona celular dhe ka pas demolim të dyerve dhe mobileve në shtëpi, nga shtëpia është marrë edhe një orë dore e markës “Ronson” .

Takimin me B. B. ma ka mundësuar B. M., jemi takuar në një restorant aty afër shtëpisë time në lagjen “Jeni Mahallë”, dhe me ka thënë se B. B. ka dëshirë me u takua me mu. Jam takuar me B. B., kam qëndruar me të nja një orë, në momentin kur jam takua me B. B., B. M. ka shkuar menjëherë, ai nuk ka qenë prezent. B. me ka tregu se kush ka hyr brenda në shtëpi, në ndërkohë unë ia kam pa orën në dorë, ia kam marrë orën, i kamë tregua se është ora ime, B. ma dha orën pa kundërshtua fare, e pyeta se ku e ke marrë orën, B. me tha se ia ka pru një tezak i tij prej Zvicrës. Unë nuk i besova ngase e disa që ora është e imja, dhe pasi e mora orën, B. me tha se pasi e more orën, mos trego në polici se ku dhe nga kush e more orën.

Në pyetjen tjetër të prokurorit si keni ardhur deri tek emrat e personave tjerë që ta kanë grabitur shtëpinë, i dëmtuari tha se prej B., ai mi ka dhënë emrat gjatë bisedës, A. D., K. K. dhe J. K., me siguri ma ka përmend edhe L. T. E kamë pyetur B. se a ka qenë pjesëmarrës, dhe me ka thënë se nuk ka qenë pjesëmarrës. Personin me emrin B. M., e njoh, e kam vendas jeton në Prizren, po nuk ia di adresën e banimit. B. në atë kohë nuk ka punuar asgjë, ka qenë periudha pas luftës. Ndoshta ai është takuar me vëllaun tim Z., nuk e di, nuk me kujtohet vëllau im Z. a ka patur ndonjë bisedë me B. Nuk ka patur nevojë të kam patur kontakte të shpeshta me B. M. Se si kamë ardhur në kontakt me B. B., B. M. me është lajmëruar në telefon që të merre iniciativën që të më takoj me B. B.M e ka ditur që më është grabitur shtëpinë, bile ka ardhur në shtëpinë time me babanë e vet për me shpreh keqardhje.

Në fund deklaron se sa i përket bashkëngjitjes së ndjekjes penale, nëse gjykata vërteton se i akuzuari është kryerësi i veprës penale, unë i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe parashtroj kërkesën pasurore juridike në shumën dikund 17.000 DM, si para të gatshme të cilën e kanë marrë grabitësit dhe në vlerën prej 10.000 DM për arin dhe gjësendet tjera të marrua në shtëpinë time.

Në shqyrtimin kryesor për datën 08.04.2016, sipas propozimit të kërkesës së prokurorit të shtetit është ftuar përsëri të dëgjohet R. B. dhe në pyetjen e prokurorit me B. B. a je takuar vet apo përmes B. M., i dëmtuari deklaroj se B. M. ma ka pru B. B. me u taku me mua. Pas grabitjes së shtëpisë time me B. B. jam takuar dy herë. Herën e parë jemi takuar afër KEK-ut, kurse herën e dytë në restorantin “E.”, kurse herën e tretë në rrojtore kur më ka pa në rrojtore, ka hy brenda dhe ma ka kërkuar orën, ia kam pa në krah orën time B., e kam njohur që është e imja, ia kam kthye krahu B. për me pa me shiqu se a është ora ime, orën ma dha vet B. kur i njëjti e ka hequr nga krahu, e kam pyetur se ku e ke marrë orën, B. më tha se ma pru një tezak prej Zvicrës. Kur ia kamë marrë orën prej dorës B., në ato momente nuk më ka thënë asgjë, në takimin e dytë te “E.” kur më ka ftuar përmes B.M. të takohemi, ai mi ka treguar personat se me kënd e ka kryer grabitjen në shtëpinë time, personat të cilat janë përmendë më herët.

Në pyetjen e mbrojtësit të akuzuarit, Av. R. K.: ju deklaruat paraprakisht në pyetjen e prokurorit se takimet me B. B. i ka organizua B. M. a ka qenë prezent ai kur jeni taku ju, deklaroj se jo, B.M i kam thënë thuj B. B. le të vjen te restoranti “E.”.

Në takimin e parë te KEK-u me B.B. nuk kam fol, ka qenë një takim rutinor, por më ka thënë që të takohemi edhe më vonë.

Në pyetjen tjetër të mbrojtësit aje i sigurte që pikërisht këta persona sipas jush kanë marrë pjesë në grabitjen në shtëpinë e juaj, deklaron se po, 100% jam i sigurte, sepse A. D. para lufte ka punuar në ndërmarrjen time dhe vëllau im e ka njohtë shumë mirë A. D., si punëtor, i cili punonte me kamionët. Unë e kam pyetur B. se për çfarë arsyeje po mi jep këta emra, ai mu ka përgjigjur për shkak të konkurrencës nga se ata kanë vepruar në dy grupe, po dua me i eliminua prej konkurrencës.

Dëshmitari B. B. deklaroj se kam dhënë disa deklarata para gjyqtarit hetues të Gjykatës së Qarkut atëherë në Prizren, mirëpo ato deklarata gjithnjë i kam mohuar, nga sepse sipas meje të gjitha ato kanë qenë montime. Sepse të gjitha deklaratat që i kam dhënë kam qenë i keqtrajtuar dhe gjithnjë kam qenë i prangosur – me pranga. E njoh J. K., atë menjëherë pas lufte nga se miqtë ku i kam unë me shpi është afër miqve të mi, por kurrë nuk jam shoqëruar me te.

Sa i përket B. M. ka kaluar një kohë e gjatë por më kujtohet se kam patur një takim me te, përndryshe e di se është nip i të dëmtuarit R. B. Ka pas raste kështu kur jemi takuar me B. M, e di që i njëjti ka punuar në një lokal në “Ortakoll”, s’jam sigurt por ashtu diçka. Në një takim B. M. më ka thënë se po flitet se edhe ti je pjesëmarrës i një grabitje që ka ndodhur në shtëpinë e R. B., unë i thash se nuk është e vërtetë dhe B. M i kam thënë se kam dëshirë të takohet me të dëmtuarin R., pasi që B.M më tha këtë fjalë.

E di se jam takuar me të dëmtuarin R. B. me insistimin e B. M., unë R. i kam thënë se unë nuk jem ai person që dyshohet për grabitje, por para se të takohem me R. unë e kam patur një ore dore “Romanson” të cilën orë e kam ble në shumë prej 600 markave, të cilin e mbajë sekret, se pikërisht për këtë vepër unë jam dënuar si i pafajshëm. Orën në fillim ma ka vërejte B. M., dhe më tha se më duket që kjo orë është e vjedhur në shtëpinë e R. B.. Unë i thash se ka mundësi që është e vjedhur, pasi që e kam ble. Po të njëjtën ditë me ndërmjetësimin e B. M., por pa prezencën e tij jemi takuar edhe me të dëmtuarin R. B., dhe atë në rrugë afër ndërtesës së KEK-ut, R. më tha se a bon me ma dhënë këtë orën, më tha se është ora ime, ta marrë, unë ia kam dhënë orën dhe i kam thënë R., që nëse dëshiron për këtë raste ta njoftojë policinë, njoftoje, e nëse jo, ma kthe orën mirëpo me mi dhënë 600 marka, se aq e kam ble, edhe ashtu u morëm vesh, mirëpo R. nuk ma ktheu as orën e as 600 markë. Orën e kamë blerë prej një X personi, i cili është nga Prizreni dhe nuk e di se ku banon dhe çka punon.

Në pyetjen e kryetarit të trupit gjykues se i akuzuari J. K. a ka qenë atë ditë me ty dhe ndonjëherë në ndonjë vepër për të cilën je dënuar, dëshmitari tha se kurrë s’ka qenë me mu dhe nuk jam shoqëruar. Shkurt personi që më ka shitë orën nuk ka qenë J. K., për atë që kam thënë R., por R. i kam thënë se nga personi i cili ma ka shitur orën më ka thënë se këtë grabitje e kanë kryer J. dhe K. K., L. T. dhe A. D., por unë nuk është e vërtetë që direkt i kam thënë R. se këta persona kanë qenë, por për këtë më ka treguar personi i cili ma ka shitë orën.

Në pyetjen e tjetër, pasi jeni takuar me të dëmtuarin R. B. afër KEK-ut dhe pasi siç po thoni ju ia keni dhënë orën në bazë të kërkesës së tij, a të kujtohet më saktë se çfarë bisede keni zhvilluar ju me të dëmtuarin, dëshmitari tha se përveç tjerash me të dëmtuarin R. kam biseduar edhe rastin e orës se B. M. më tha se ora është apo është vjedhur nga shtëpia e këtu të dëmtuarin R. B., R. më tha a po ma jep qatë orë ta këqyri dhe pasi ia dhashë, e këqyri dhe tha se ora është e imja, po shkojë në shtëpie dhe ta verifikojë me numra serik, unë i thash merre orën verifikoje po nëse del ora që nuk është e jotja, ma kthen mua, nëse e ndalish mi japish 600 markë, i dëmtuari ka dyshuar tek unë mos ndoshta kam marrë pjesë në grabitje, atij ia kam dhënë edhe emrat: por këto të dhëna ia kam dhënë në bazë të personit nga i cili e kam blerë orën, por nuk besojë se J. të ketë bërë këto sende apo të kryejë grabitje, dhe as nuk kam dëgjuar një gjë të tillë.

Gjithashtu ky dëshmitar u ftua me propozimin e Prokurorit të shtetit, u ftua përsëri dhe u dëgjua në cilësinë e dëshmitarit në shqyrtimin kryesor me dt.25.03.2016, i njëjti ka deklaruar: meqenëse ka kaluar një kohë e gjatë dhe kanë kaluar shumë gjëra, ora e cila përmendet në aktakuzë, atë e kam blerë në vlerë prej 600 marka.

Në pyetjen e Kryetarit të trupit gjykues, a mundesh me na shpjegua se si ka qenë ndërmjetësimi në mes B. M. dhe R. B., a ki njohuri, dëshmitari deklaroj unë me B. M jam takuar mos gabofsha në një lokal se si jam njoftuar me të nuk më kujtohet gjatë bisedës me B. M, kur merr vesh se kush jam unë, ai më thotë mua se duke më thënë se të dëmtuarin R. B., apo diçka të afërt, B. M. më ka thënë se ke bo grabitjen në filan vendin duke ma cekur edhe vendin, ma ceki se edhe në shtëpi është marrë edhe ora e dorës, edhe pse unë më parë kam qenë i njoftuar me orën, dhe orën e kam blerë siç kam deklaruar më herët, nuk kam qenë i interesuar rastin nga se në atë kohë kam qenë në arrati, dhe prej B. M kam kuptuar dyshimin se unë e kam vjedhur atë orë, unë i kam thënë B. M që mund ta takojë atë tezakin tënd – R. dhe unë i tregojë lidhur me orën se si ka ardhur gjer tek unë. Jam takuar me R. afër shtëpisë së mallrave ia kam dhënë orën R. ka shkuar dhe e ka verifikuar se numri serik a përputhet me orën të cilën unë ia kam dhënë atij, ma pru orën dhe pastaj përsëri ka kërkuar orën për me ia dorëzua policisë por me kusht që mua të më paguajë 600 marka.

Sa i përket J. K. atë e kam njoftë në ato kohëra kur edhe rreth shtëpisë së tij kam kaluar shumë herë kur kam shkuar te miqtë e mi veç e kam pa **mirëpo shoqëri me te nuk kam pas.**

Në pyetjen tjetër a e din personin se kush ta shiti orën siç deklarove në shumën prej 600 DM, theksoj se e njohë personin, nuk e kam treguar atëherë, as sot nuk e tregojë.

Se a ka patur ndonjë lidhje me shitje këtu i akuzuari J. K., deklarom se jo, J. K. nuk ma ka shitë orën.

Në pyetjen e prokurorit, atë ditë kur je takuar me R. B. përmes B. M. a të kujtohet si person a ia ke dhënë ndonjë emër gjegjësisht ai të ka kërkuar nga ti me treguar se prej nga e ke marrë orën, dëshmitari tha se unë i kam treguar R. B. dhe prej kujt e kam blerë orën, nuk i kam treguar se prej kujt e kam blerë orën, por personi që ma ka shitë orën më ka thënë që veprën e kanë kryer A. D., L. T., K. K. dhe J. K., ashtu më ka thënë personi që ma ka shitë orën, por unë edhe atëherë edhe sot deklaroj se J. K. nuk ma ka shitë orën. Personi nga i cili e kam ble orën nga është dhe çfarë profesioni ka, dëshmitari tha se është nga Prizreni por profesionin e tij nuk ia di.

Në pyetjen tjetër të prokurorit se gjatë procedurave të mëhershme kur je marrë në pyetje gjatë hetimeve dhe gjykimeve keni deklaruar që këtë orë ua ka dhënë si dhuratë një person nga Zvicra gjegjësisht një nip, tani po thoni se personi jeton në Prizren, cila është e vërteta, deklarom se, deklarom se e vërteta është tash çka e them se orën të cilën e kam blerë, personi është nga Prizreni.

Në pyetjen tjetër se nga personi që e keni blerë orën a është i implikuar në rastin që është në gjykim tani, deklarom se nuk e di.

Në pyetjen e kryetarit të trupit gjykues, gjatë marrjes në pyetje të dëmtuarit R. B. ndër të tjera në pyetjen e prokurorit si keni aradhe deri te emrat e personave tjerë që të kanë grabitur shtëpinë, i dëmtuarit thotë se B. B. mi ka dhënë emrat gjatë bisedës, A. D., K. K. dhe J. K. dhe me siguri më ka përmendë edhe emrin L. T., e shtrohet pyetja a ia ke dhënë ti këta emra a është e vërtetë se të dëmtuarit R. B. ia ke dhënë emrat të cilët i përmende, dëshmitari tha se në bazë të dhënave që nga personi nga i cili e kam blerë orën më ka thënë se veprën e kanë kryer pikërisht këta persona A. D., K. K. dhe J. K. duke përmendë edhe emrin e L. T., por nuk është e vërtetë që unë të dëmtuarit R. t'ia kam dhënë emrat direkt, nga se me L. T. kur në jetë se kam njohur, siç deklarova edhe ma herët këtu J. K. e kam njohur përreth rrugës së tij kur kam shkuar te prindit e bashkëshortes.

Deshmitari B. M., në pyetjen e kryetarit të trupit gjykues a je në rrjedha dhe a ke ndonjë dijëni rreth një grabitje që ka ndodhë në shtëpinë e të dëmtuarit R. B. këtu në Prizren, deklaroj, po, kam dijëni, kam dhënë deklaratë në polici dhe para gjyqtarit hetues.

Gjatë shqyrtimit kryesor lidhur me lëndën penale ndaj të akuzuarit B. B. e tjerë nuk kam dhënë asnjë dëshmi, e njoh R. B. nga se jemi nga i njëjti fshat ku edhe jemi rritur bashkë. R. pas luftës a ka banu në lagjen “Jeni Mahall”. Të nesërmen pas ngjarjes në shtëpinë e tij, R. me telefon e ka thirrë axhën tim R. M. dhe i ka thënë se dikush i kanë hyrë brenda në shtëpinë e tij dhe më kanë plaçkitë, atëherë axha na muar mua dhe vëllaun dhe shkuam në vizitë në shtëpinë e R., me pa kur arritëm në shtëpinë e tij aty takuam R., i cili ishte i lënduar mbi vetullën ka patur një mavijosje në të zezë, na ka treguar që plaçkitësit ia kishin marrë disa të holla, disa flori. E kam njohur B. B., në atë kohë kisha një market me gjëra ushqimore etj, në lagjen “Ortakoll” dhe aty B. vinte dhe blinte cigare. Një ditë në market B. i ka ardhur me një orë të dorës dhe me trenerka – sportive të bardha, dhe e pyeta se këtë orë ku e ke marrë, B. më tha “e kam ble”, B. i thash që kësi ore ka patur edhe axha, qenka indentik si i axhës R., (ashtu e kam thirrë axha R., kurse në fafesisni nuk jemi me te jemi kojshi), pas kësaj, unë e kam lyp pastaj B. orën, për me ia qu R., të njëjtën ditë kur i kam thënë, “B. më tha ta jap orën”, në të kundërtën do t’mi kthejsh 3000 apo 5000 marka, unë i frigova me ia marrë orën B. se nuk kisha pare, dhe i thash B. se a mundesh me u taku personalisht me R., ose me vëllaun e R., B. më tha po, dhe Z. ia dha numrin B. të telefonit dhe B., Z, dhe nuk e di pastaj se çka është bërë.

Në pyetjen tjetër të kryetarit të trupit gjykues se a keni marrë ju iniciativën që të takohen R. B. dhe B. B., **dëshmitari tha se jo, unë nuk kam marrë iniciativën por kanë komunikuar në mes veti Z. me B., se a janë takuar B. dhe Z. dhe R. unë nuk kam njohuri**, më vonë më ka ftuar edhe policia dhe kam dhënë një deklaratë, të njëjtën deklaratë sikur që e dhashë sot.

KTGJ: pasi që deklaruat se B. iu ka treguar se orën e ka blerë, mos ndoshta ka treguar personin se prej kujt e ka blerë, dëshmitari tha se jo, nuk ka treguar. Se çfarë marke ka qenë ora e dorës, mua nuk më kujtohet. Kur kemi shkue te shtëpia e axhës R. kamë kuptuar se ka qenë i plaçkitur, atë natë mi ka treguar sendet e vjedhura që i ceka më lartë mirëpo lidhur me një aparat të ndërtimtarisë të cilën e kam patur mbi rrëgall, për këtë ngjarje kam kuptuar pas disa ditëve ma vonë.

Në pyetjen tjetër pas kësaj ngjarje që ke kuptuar që është plaçkitur shtëpia e axhës R., sa herë je takuar me B. B., dëshmitari tha se për çdo ditë vinte dhe blinte cigare në marketin tim, pasi që aty afër në lokalin “K.” shpesh pinte kafe B. Unë kam qëndruar në lokal, B. vinte blinte cigare dhe shkonte.

Në pyetjen a je takuar me B. edhe në ndonjë vend tjetër, dëshmitari tha se jo. Unë nuk e di se a janë takuar apo jo axha R. me B., dhe nuk kam qenë ndërmjetësues fare në mes të R. dhe të B. në ndonjë vend.

Në pyetjen e KTGJ: pasi që më parë deklarove se në shtëpinë e R. ke shku me vëllaun të nesërmen, a të ka treguar R. rastësisht se a ka kuptua se kush e ka bërë këtë veprim, dëshmitari tha jo nuk më ka treguar.

Në pyetjen e anëtarit të trupit gjykues: kur je takuar për herë të parë me B. dhe ia ke parë orën i ke thënë që edhe axha im R. e ka një orë të tillë a të kujtohet a kish pas njohuri për vjedhjen që është bërë në shtëpinë e R., dëshmitari u përgjigj se unë nuk i kam hy atij muhabeti përveç se kur siç ceka më lartë se axha R. ka patur një orë identike me orën të cilën ed mbanë ti.

Mbrojtësi i të akuzuari av. R. K. në fjalën e tij përfundimtare deklaroj: se në bazë të administrimit të provave të shqyrtuara pranë kësaj gjykate dhe këtij trupi gjykues, nuk është vërtetuar në asnjë mënyrë se këtu i akuzuarit J. K. të ketë marrë pjesë në kryerjen e veprës penale të grabitjes të nenit 255 par 3 lidhur me par 1 të KPK. Konsiderojmë se pretendimet e Prokurorisë së Shtetit të cilat po sa i dëgjuam në fjalën e tij përfundimtare, nuk qëndrojnë nga se nuk është paraqitur asnjë provë konkrete e cila do të mbështet dyshimin e bazuar që i akuzuari të ketë kryer veprën penale e që është objekt i kësaj aktakuze. Në bazë të rekomandimeve të gjykatës së shkallës së dytë, është ftuar si dëshmitar B. B. i cili shprehimisht dhe në mënyrë precize, i cili në pyetjet e prokurorit po ashtu edhe të trupit gjykues ka deklaruar se J. K. më dt.17.08.2000 nuk ka marrë pjesë në kryerjen e veprës penale të grabitjes, po ashtu vlen të ceket se si e njeh J. K., ai thotë se e kam njohur vetëm si person i cili jeton në lagjen ku i ka miqtë e tij, apo bashkëshortes së tij, kurse kontakte tjera nuk ka pas asnjëherë, madje këtë pohim e ka përsëritur edhe në seancën e radhës që është pyetur si dëshmitar, me dt.11.01.2016 dhe të dt.25.03.2016.

Sa i përket dëshmisë së dëshmitarit R. B. konsiderojmë se nuk duhet fal besimin e tij sepse gjatë deklaratave të cilat i ka dhënë para kësaj gjykate ishin kontradiktore me vetë veten dhe si e tillë, deklaratës së tillë nuk duhet besuar, sepse me një deklaratë, deklaroi se këtu i akuzuari J. K. nuk ka qenë fare dhe as që e njeh të njëjtin, kurse në deklaratën tjetër i referohet në dëshminë e deklaratës së B. B. se ai paska thënë se J. K. ka marrë pjesë në grabitjen e dt.17.02.2000. Parashtrohet pyetja cilën deklaratë duhet të marrë si të vërtet, e unë konsideroj se deklarata e dhënë me 08.04.2016 i referohet se i ka thënë dikush edhe pse vetë nuk e ka njohur as nuk ka mund të përshkruan figurën që mund ti përngjan këtu të akuzuarit J. K. Konsideroj se duhet marrë parasysh edhe deklaratën e dëshmitarit B. M. i cili i përshkruan mjaft mirë kontaktet që ka pas me B. B. kurse me J. K. as që nuk e njeh e as nuk e ka pa. Kështu që konsiderojmë se këto janë mjaft prova të cilat vërtetojnë se këtu i akuzuari J. K. nuk ka marrë pjesë e as që ka pas lidhje me grupin i cili akuzohet edhe i akuzuar edhe më parë për kryerjen e veprave penale siç thuhet në aktakuzën e prokurorisë së shtetit. Nëse i referohemi deklaratës të dëmtuarit R. B. se është përmend një person me emrin A. D. ka punuar si kamionist – si shofer kamioni në firmën e tij, në bazë të informacioneve që kam se është dëshmuar vetë nga A. D. dhe asnjë herë nuk ka punuar i njëjti në firmën e tij.

Nga të dhënat që thamë, rrjedhë se i akuzuari nuk ka pas mundësi dhe nuk është vërtetuar të ketë marrë pjesë apo të ketë qenë i involuar në veprën penale të grabitjes nga neni 255 par3 lidhur me par 1 të KPK-ës.

Trupit gjykues i propozoj që pas vlerësimit të provave të nxjerrë aktgjykim lirues, ndaj këtu të akuzuarit J. K., meqë me asnjë provë nuk është vërtetuar se i njëjti ka kryer veprën penale të grabitjes nga neni 255 par 3 lidhur me par 1 të KPK-ës.

I akuzuari J. K. në fjalën e tij përfundimtare thekson se në tërësi mbështetë mbrojtësin – avokatin e tij duke konsideruar veten të pafajshëm, për të gjitha veprat penale të përshkruara si në dispozitiv të aktakuzës.

Trupi gjykues vlerësoj mbrojtjen e të akuzuarit, av. R. K., dhe i njëjti kishte të drejt në kërkesën e tij për të liruuar të akuzuarin për mungesën e provave që do të qonin në vërtetim se i akuzuari B. B. ishte kryerës i veprave penale për të cilat është akuzuar.

Serish gjykata e shkallës së parë ka vepruar sipas rekomandimeve të Gjykatës Supreme ku nder të tjera është theksuar se i akuzuari B. B. (si bashkëkryerës) është dashur të dëgjohet në

cilësi të dëshmitarit, pavarësisht nga informata e SHPK-së, më të cilin informohet gjykata se nuk mundë të sigurohet prezenca e tij në gjykatë nga institucioni ku vuan dënimin, sepse qenka i burgosur i kategorisë A, e arsyetimi i këtillë me aktgjykimin e goditur është në kundërshtim me dispozitat e përmendura ligjore.

Gjykata ka ftuar në dy shqyrtime dëshmitarin B. B. dhe në pyetjen e kryetarit të trupit gjykues se i akuzuari J. K. a ka qenë atë ditë me ty dhe ndonjëherë në ndonjë vepër për të cilën je dënuar, dëshmitari tha se kurrë ska qenë me mu dhe nuk jam shoqëruar. Shkurt personi që maka shitë orën nuk ka qenë J. K., për atë që kam thënë R., por R. i kam thënë se nga personi i cili ma ka shitur orën më ka thënë se këtë grabitje e kanë kryer J. dhe K. K., L. T. dhe A. D., por unë nuk është e vërtetë që direkt i kam thënë R. se këta persona kanë qenë, por për këtë më ka treguar personi i cili ma ka shitë orën. Se a ka patur ndonjë lidhje me shitje këtu i akuzuari J. K., deklaron se jo, J. K. nuk ma ka shitë orën.

Ky dëshmitar pastaj është pyetur se ku qëndron arsyeja që nuk po ia tregon emrin e tij, (fjala ka qenë për personin që ia ka shit orën B.) dëshmitari tha se nuk dëshirojë ti komplikoj punët, për këtë vepër kam mbajte 8 vjet burgim, dhe kur dal prej burgut besoj që i rregullojë punët, **ai person nuk është prezent.**

Trupi gjykues gjithashtu vërteton se i akuzuari J. K. nuk ka patur lidhje me shitjen e orës së dorës këtu dëshmitarit B. B., e ky fakt u vërtetar nga deklarata e B. B. i cili kur është pyetur se a ka patur ndonjë lidhje me shitje këtu i akuzuari J. K., deklaron se jo, tha se J. K. nuk ma ka shitë orën.

I dëmtuari R. B. në deklaratat e tija ishte i pakjart, i dëmtuari në një deklaratë të tij thotë se takimin me B. B. ma ka mundësue B. M., kurse B. M. kur është pyetur në cilësinë e dëshmitarit se a keni marrë ju iniciativën që të takohen R. B. dhe B. B., ky dëshmitar tha se jo, tha se unë nuk e kamë marrë iniciativën por kanë komunikuar mes veti Z. (vëllau i R. B.) me B. dhe se a janë takuar këta, ky dëshmitar tha se nuk ka njohuri. Kontestues e dhe kontradiktore ishin deklarata e të dëmtuarit se B. B. ia paska treguar emrat e personave që kanë marrë pjesë në grabitjen e shtëpisë së dëmtuarit, mirëpo një gjë e till u demantua nga dëshmitari B. B. ku tha se nuk është e vërtetë që unë të dëmtuarit R. t'ia kam dhënë emrat direkt.

Pra, me marrjen direktë në pyetje të dëshmitarit B. B. i cili në procedurat penale kundër tij si akuzuar ku ka deklaruar se veprën penale në dëm të dëmtuarit R. B. e ka kryer me personat tjerë, ai në shqyrtimet e fundit ka deklaruar se J. K. **kurrë s'ka qenë me mu as ditën kritike në shtëpinë e R. B. e as në veprat tjera duke thënë se nuk jam shoqëruar më J. K.** dhe në shqyrtimet e fundit ai person nuk është prezent.

Vepra penale grabitja nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të KPK

***par.1-** Kushdo që e përvetëson pasurinë e luajtshme të personit tjetër me qëllim që ti sjellë vetes apo tjetërit dobi pasurore të kundërligjshme, duke përdor dhunën apo kanosjen kundër personit tjetër se do ta sulmoj atqashëm jetën apo trupin e personit tjetër *debohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

*Par.3, nëse vepra penale nga paragrafi një i këtij neni kryhet nga kryersi duke vepruar si anëtar grupi ose duke përdor ndonjë armë a mjet të rrezikshëm, kryersi dënohet me burgim prej 3 deri në dymbëdhjetë vjetë.

Sipas mendimit të trupit gjykues përfaqësuesi i akuzës ka për detyrë që të paraqes prova të mjaftueshme për të vërtetuar të gjitha elementet e më sipërme të veprës penale përtej dyshimit të arsyeshem, me qëllim të siguroj se i akuzuari më të vërtet është i fajshëm.

Më të marrë vendimin lidhur me lirimin e të akuzuarit për veprën penale të cekur si më lartë, trupi gjykues analizoj të gjitha provat materiale dhe dëshmitë e të dëmtuarit dhe dëshmitarëve.

Trupi gjykues në tersi i besoj dhe e muarr për bazë dëshminë e dëshmitarit B. B., i cili me aktgjykim të plotfuqishëm është shpallur fajtor dhe është dënuar me 8 (tetë) vite burgim sepse deklarata e tij ishte bindëse për trupin gjykues, pastaj edhe deklarata e dëshmitarit B. M. kur tha se **Unë nuk e di se a janë takuar apo jo axha R. me B., dhe nuk kam qenë ndërmjetësues fare në mes të R. dhe të B. në ndonjë vend.**

Gjithashtu trupi gjykues e analizoj edhe deklaratën e të dëmtuarit R. B., i cili përveç që e tregoj ngjarjen, nuk dha ndo një dëshmi dhe nuk vërtetoi se këtu i akuzuari ka qenë pjesëmarrës në grabitjen që ka ndodhur në shtëpinë e tij, edhe në një deklaratë vet thotë se Unë si i dëmtuar pa fakte dhe prova nuk mundë të deklaroj se mundë të dyshoj tek i akuzuari J. K. nga se as nuk e kamë pa, sot për herë të parë po e shofë gjykim.

Pra gjykata e shkalles së parë, sipas rekomandimeve të Gjykatës Supreme eliminonjë të gjitha shkeljet, dëgjoj të akuzuarin J. K., të dëmtuarin R. B. dhe dëshmitarët B. B. dhe B. M., analizoj të gjitha provat materiale dhe erdhi në përfundim se nuk u provua se i akuzuari të J. K. të ketë kryer veprën penale grabitje nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të KPK, për çka edhe në mungesë të provave, gjykata të akuzuarin J. K. në kuptim të nenit 390 par.3 të KPPK. e liroj nga akuza.

Trupi gjykues venë re se të drejtat themelore të mbrojtjes kanë ruajtur mbrojtjen e njëjtë kushtetuese pavarësisht a zbatohet KPP apo KPP i aplikuar sipas Dekretit të UNMIK-ut.

Nga të gjitha këto që u thanë si më lartë, gjykata vendosi si në shqiptim të këtij aktgjykimi

Vendimi mbi kërkesën pronësore juridike u muar në kuptim të nenit 463 par.2 të KPP.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale dhe paushalin gjyqësor u muarr në kuptim të nenit 450 të KPP.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti për Krime të Rënda
P.nr.146/2006, dt.27.04.2016

Sekretrja Juridike
Fatmire Kastrati

Kryetari i trupit gjykues
Xheladin Osmani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, me anë të kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

